Zyra. Kryetarit

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Më/Dana 29.09.2022
Nr.I organit / Org.broj 01- | Numri/Broj 110/ | Shtojcë / Prilog 05- | Vlera / Vrednost 1070

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d, nenit 40, pika 2, shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.09.2022, merr këtë:

# V E N D I M

**Për shpalljen "qytetarë nderi" i Komunës së Vitisë, drejtoreshën ekzekutive të MCC-së z. Alice P.Albright**

**Neni 1**

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë shpall qytetar nderi të Komunës së Vitisë, drejtoreshën ekzekutive të MCC-së z.Alice P. Albright.

**Neni 2**

Titulli qytetare nderi i Komunës së Vitisë z.Alice P. Albright, sipas këtij propozim vendimi do të ndahet nga kryetari i komunës, i cili autorizohet të përcaktoj formën e dekoratës, mënyrën e dhënies si dhe çështjet tjera sa i përket organizimit të ndarjes së titullit në fjalë për z.Alice P. Albright.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

**Neni 4**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1. Zyrës së Kryetarit;
2. Shërbimit të Kuvendit; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi